

8 janar 2026,
Prishtinë

Bazuar në Rregulloren për Punën e Komisionit të Ankesave dhe të Arbitrazhit të Federatës së Basketbollit (FBK) të datës 31.01.2025, dhe Rregullores për Regjistrim dhe Kalim (RRRK) të datës 20.08.2025, dhe Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore Edicioni 2025/2026 të datës 20.08.2025 (PG), si dhe sipas Ankesës së KB Vëllaznimi të datës 07.01.2026, Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit i FBK-së (“KAA”), me datë 08.01.2026 merr këtë:

V E N D I M

- I. Shpallet e PRANUESHME Ankesa e KB Vëllaznimi e datës 07.01.2026;
- II. REFUZOHET Ankesa e KB Vëllaznimi e datës 07.01.2026 si e PABAZUAR;
- III. VËRTETOHET Vendimi Nr. 20/2025-26 i Komisionit të Garave i datës 07.01.2026.

A R S Y E T I M

Më datë 07.01.2026, Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit i FBK-së (“KAA”), përmes postës elektronike, nga Sekretarja e FBK, ka pranuar Ankesën e KB Vëllaznimi të datës 07.01.2026 (tash e tutje “Ankesa”), e cila ka të bëjë me Vendimin me nr. 20/2025-26 të Komisionit të Garave të datës 07.01.2026, (tash e tutje “Vendimi”), lidhur me refuzimin e kërkesës së KB Vëllaznimi për lejimin e regjistrimit të lojtarit Derek Wilson si “free agent jashtë afateve kalimtare, në përputhje me nenin përkatës të Rregullores së FBK-së për Regjistrim dhe Kalim të Lojtarëve.”

Në këtë kuadër, KAA ka mbajtur takim lidhur me çështjen në fjalë, më 08.01.2026, dhe ka shqyrtuar Ankesën e KB Vëllaznimi, si dhe provat e tjera që janë pjesë e dosjes së lëndës dhe të ofruara nga sekretaria.

Sipas kuptimit të KAA, KB Vëllaznimi sfidon Vendimin e KG të identifikuar më sipër duke pretenduar ndër të tjera se KG ka aplikuar gabimisht Nenin 30.4 të RRRK-së si bazë për refuzim të regjistrimit të lojtarit në fjalë si lojtar i KB Vëllaznimi. Rrjedhimisht, kërkon ndër të tjera nga KAA që të anulohet Vendimin e KG, të konstatojë se Neni 30, pika 4 nuk është i aplikueshëm në rastin e lojtarit Derek Wilson, dhe të kthejë çështjen për rishqyrtim ose të vendosë lejimin e regjistrimit të lojtarit Derek Wilson në përputhje me rregulloret në fuqi.

KAA vëren nga provat në shkresat e lëndës, dhe është e pakontestueshme, se KB Vëllaznimi ka dorëzuar brenda afatit ankesën e tyre ndaj Vendimit të Komisionit të Garave, dhe rrjedhimisht, konsiderohet si ankesë e pranueshme sepse janë përmbushur të gjitha kushtet, përfshirë edhe pagesën e taksës për ankesë.

KAA gjatë trajtimit të lëndës ka shqyrtuar të gjitha dokumentet përkatëse dhe provat në dispozicion, bazën ligjore dhe nënligjore, dhe rregullativën e brendshme të FBK-së, dhe ka konstatuar si në dispozitiv, për arsyet në vijim.

Kërkesa e KB Vëllaznimi e datës 05.01.2025 që i është bërë KG për regjistrim të lojtarit Derek Wilson, thotë:

Me anë të kësaj kërkesë, klubi ynë KB Vllaznimi kërkon miratimin e Komisionit të Garave për regjistrimin e lojtarit Derek Wilson (Forward, lindur më 6.07.1991) për pjesëmarrje në sezonin 2025/2026.

Lojtari:

- është i lirë nga çdo kontratë aktivisht,
- nuk ka zhvilluar ndeshje zyrtare në sezonin 2025/2026,
- ka përfunduar kontratën e tij të fundit pa asnjë detyrim ndaj klubit të mëparshëm,
- plotëson kriteret për t'u regjistruar si free agent jashtë afateve kalimtare, në përputhje me nenin përkatës të Rregullores së FBK-së për Regjistrim dhe Kalim të Lojtarëve.

Bashkangjitur me këtë kërkesë janë:

1. Kontrata e re e propozuar mes klubit dhe lojtarit.
2. Pagesa për regjistrim
3. Pasaporten

Bazuar në rregulloren aktuale, dhe duke qenë se lojtari është free agent dhe pa ndeshje të regjistruar në sezonin aktual, kërkojmë miratimin e Komisionit të Garave për regjistrimin e tij të menjëhershëm te ekipi ynë. Faleminderit për shqyrtimin e kësaj kërkesë dhe mbështetjen e vazhdueshme për zhvillimin e basketbollit në Kosovë.

KAA vën re se kërkesa e KB Vëllaznimi bazohet në RRRK (e jo në PG), dhe se është e hartuar në mënyrën që është e arsyeshme të interpretohet se është kërkuar si transfer jashtë afateve kalimtare. Rrjedhimisht, zbatimi i Nenit 30.4 të RRRK nga KG ka qenë i arsyeshëm, bazuar në kërkesën e KB Vëllaznimi dhe mënyrën se si është hartuar. KB Vëllaznimi duhet kuptuar se KG e ka të pamundur të dalë jashtë kërkesës së klubit apo të jep interpretime jashtë asaj se çka shkruhet në kërkesë nga vet klubi.

Në anën tjetër, nëse lidhur me lojtarin Derek Wilson, KB Vëllaznimi do të bënte kërkesë që ai të regjistrohet si lojtar i KB Vëllaznimi në përputhje me Nenin 13.16 të PG, atëherë, kuptohet që KG do të kishte mundësinë që të njëjtën kërkesë ta aprovojë nëse përmbushen kushtet, e që bazuar në provat që ka KAA duket se plotësohen por mbetet të vlerësohen nga KG. Neni 13.16 i PG thotë:

Afati i fundit për regjistrimin e lojtarëve të huaj për ekipet e Superligës Meshkujt është 72 orë para fillimit të xhiros së XXII të Superligës (para fillimit të pjesës së katërt), ndërsa për ekipet e Superligës Femrat është 72 orë para fillimit të raundit të tretë të kampionatit.

Bazuar në këtë, dhe faktin se ende nuk është tejkaluar afati 72 orësh para fillimit të xhiros së XXII të Superligës, KB Vëllaznimi është i lirë që të bëjë kërkesë tek KG sipas Nenit 13.16 të PG për regjistrim të lojtarit Derek Wilson si lojtar i KB Vëllaznimi, me që rast, KG do të kishte mundësinë që të shqyrtojë këtë kërkesë sipas bazës adekuate ligjore që i përket regjistrimeve të tilla.

Duke vlerësuar kështu, KAA nuk ka asnjë bazë ligjore ose të rregullativës së FBK-së, e cila do të arsyetonte përmbushjen e kërkesave ankimore të KB Vëllaznimi në ankesën e parashtruar, prandaj, ato refuzohen si të pabazuara. Prandaj, KAA duke u mbështetur në atë që u tha më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Komisioni i Arbitrazhit:



Partin Pruthi
Anëtar



Korab R. Sejdiu
Kryetar



Lulzim Fushtica
Anëtar

Prishtinë, 8 janar 2026

Vendimi i dërgohet:

- KB Vëllaznimi
- Komisionit të Garave të FBK-së
- Anëtarëve të Komisionit të Arbitrazhit
- Arkivit të FBK-së



Këshilla Juridike:

Vendimet e Arbitrazhit janë definitive, dhe kundër tyre nuk është e lejuar ankesa brenda FBK-së. Palët e pakënaqura me vendimin e KAA kanë të drejtë të ankesës tek Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS) dhe në Gjykatën kompetente përkatëse.